

# Shkolla të tepërta?

Ristrukturimi i rrjetit të institucioneve  
edukativo-arsimore  
parauniversitare



—  
Maj 2021

## **Shkolla të tepërta?**

Ristrukturimi i rrjetit të institucioneve  
edukativo-arsimore parauniversitare

Maj 2021

## — **Përmbajtja**

- 3** Përmbledhje Ekzekutive
- 4** Hyrje
- 6** Kriteret për themelimin dhe  
pushimin e veprimtarisë së  
institucioneve edukativo-  
arsimore
- 7** Kriteret për raportin  
mësimdhënës-nxënës
- 8** Statistika të përgjithshme  
rreth arsimit parauniversitar
- 16** Gjendja e shkollave në  
komuna
- 19** Përfundim

## Përmbledhje Ekzekutive

Politikat e gjertanishme të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (tani Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit - MASHTI) në arsimin parauniversitar janë fokusuar në ndërtimin e objekteve të reja shkollore, shtimin e hapësirës shkollore për kokë nxënësi/je dhe përpilimin e strategjive mbi cilësinë e arsimit.

Dokumentet strategjike të MASHTI, si: Plani Strategjik i Arsimit në Kosovës 2017-2021<sup>1</sup> dhe Strategjia e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin Parauniversitar 2016 – 2020<sup>2</sup>, nuk e trajtojnë fare problemin e rënies së numrit të nxënësve, shkollat dhe klasat me pak nxënës dhe uljen e proporcionit nxënës-mësimdhënës.

Duke parë rënien e numrit të nxënësve dhe rritjen e shpenzimeve për mirëmbajtjen e shkollave, Komuna e Kamenicës<sup>3</sup> ka filluar një reformë në riorganizimin e shkollave, duke mbyllur shkollat me pak nxënës dhe duke organizuar transport për bartjen e nxënësve. Kjo reformë u kundërshtua nga prindërit, banorët e lokaliteteve ku parashihet mbyllja e shkollave, partitë politike, si dhe nuk gjeti përkrahje nga MASHTI. Procesi mësimor u bojkotua në shumicën e shkollave në Komunën e Kamenicës duke shkaktuar humbjen e orëve për shumë nxënës. Prindërit protestuan para komunës dhe ministrisë.

Avokati i Popullit hartoi raport sipas detyrës zyrtare dhe në gusht të vitit 2020 doli me konstatime se Komuna e Kamenicës ka shkelur të drejtat e fëmijëve për arsim dhe se reforma është në kundërshtim me ligjet në fuqi të vendosura nga MASHTI.<sup>4</sup>

Por, çfarë parasheh ristrukturimi i rrjetit të shkollave në Komunën e Kamenicës dhe a ka rënie të proporcionit nxënës-mësimdhënës edhe në komunat tjera? Në këtë raport të Institutit GAP, duke u bazuar në statistikat vjetore të MASHTI dhe në të dhënat e siguruara nga 19 komuna, kemi dhënë një pasqyrë sa i përket trendeve në arsimin parauniversitar, si numri i nxënësve, numri i personelit arsimor dhe relacioni nxënës-mësimdhënës. Po ashtu, në këtë raport është bërë krahasimi i komunave sa i përket rënies dhe rritjes së numrit të nxënësve dhe personelit arsimor, si dhe relacionet nxënës-mësimdhënës.

Të gjeturat tregojnë se nga viti shkollor 2008/2009 deri në vitin shkollor 2019/2020, numri i nxënësve ka rënë për 26%, apo për 114,323 nxënës. Në bazë të të dhënave të siguruara nga 19 komuna, del se janë 340 klasa që kanë pesë e më pak nxënës dhe 642 klasa që kanë më pak se dhjetë nxënës. Përderisa ka rënie të numrit të nxënësve, të dhënat tregojnë se personeli arsimor (mësimdhënës, personel administrativ dhe ndihmës) është rritur për 2% për të njejtën periudhë krahasuese.

Për të pasur një pasqyrë më të plotë në nivel të shkollave në secilën komunë, MASHTI duhet të përfundojë sa më parë studimin e detajuar për riorganizimin e shkollave me pak nxënës, ashtu siç parashihet në memorandumun e nënshkruar me Komunën e Kamenicës.

1 MASHTI. Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021. Korrik 2016, Prishtinë: Burimi: <https://bit.ly/3tx3tYX>

2 MASHTI. Strategjia e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin Parauniversitar 2016-2020. Burimi: <https://bit.ly/2Qj4AgI>

3 Dhe në shkallë më të kufizuar Komuna e Drenasit.

4 Institucioni i Avokatit të Popullit. Raport me rekomandime, Ex-Officio, Rasti nr. 720/2019 kundër Komunës së Kamenicës, në lidhje me riorganizimin e arsimit parauniversitar në Komunën e Kamenicës. 19 gusht 2020. Burimi: <https://bit.ly/2NsbGOM>

## Hyrje

Në vitin 2018, Komuna e Drenasit mbylli tri shkolla në tri fshatra për shkak të rënies së numrit të nxënësve. Ky vendim i Komunës së Drenasit shkaktoi rezistencë tek banorët e këtyre lokaliteteve, por arriti të zbatohet.

Një vit më vonë, Komuna e Kamenicës, me të njejtin arsytim, ndërmoi një reformë më të thellë, duke mbyllur gjysmën e shkollave. Ky veprim shkaktoi rezistencë shumë më të madhe tek prindërit dhe partitë politike opozitare në Kamenicë, dhe mori vëmendjen e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Në shkurt të vitit 2020, MASHTI i kërkoi Komunës së Kamenicës që të shtyjë ekzekutimin e vendimit për mbylljen e shkollave, si dhe mori përsipër kryerjen e një hulumtimi gjithëpërfshirës për të parë se si është gjendja me shkollat me pak nxënës edhe në komunat tjera.

Por, deri më tani nuk është kryer një studim i tillë. Në këtë raport, Instituti GAP jep një pasqyrë të përgjithshme sa i përket trendit të rritjes/rënies së numrit të nxënësve në të gjitha komunat, si dhe trendit të rritjes/rënies së personelit nëpër shkolla. Duke u bazuar në ligjet dhe aktet nënligjore për arsimin parauniversitar, kemi krahasuar edhe raportin nxënës-mësimdhënës në të gjitha komunat dhe kriteret për numrin e nxënësve për klasë.

Po ashtu, Instituti GAP ka dërguar kërkesa për qasje në të dhënat zyrtare në drejtoritë e arsimit, në të gjitha komunat, duke kërkuar të dhëna të detajuara për numrin e shkollave, numrin e nxënësve për shkolla dhe klasë, personelin arsimor për secilën shkollë. Përgjigje kemi marr nga 22 komuna. Por, shumica e komunave kanë dërguar të dhëna të mangëta. Për ato 19 komuna që kemi siguruar të dhëna të plota, kemi paraqitur një pasqyrë më të detajuar për shkollat të cilat kanë probleme më të theksuara sa i përket numrit të nxënësve.

Në këtë raport nuk është trajtuar problemi i infrastrukturës nëpër shkolla, si dhe modalitetet e transportit të nxënësve dhe risistemimit të personelit arsimor.

## Baza ligjore e arsimit parauniversitar

*Ligji për arsimin parauniversitar*<sup>5</sup> rregullon edukimin, arsimin dhe aftësimin parauniversitar. Niveli qendror dhe lokal ndajnë përgjegjësitë për organizimin e arsimit parauniversitar. Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASHTI) mban përgjegjësinë kryesore për planifikimin, caktimin e standardeve dhe sigurimin e cilësisë së sistemit të arsimit parauniversitar. Kurse, kompetencat e komunave janë të rregulluara përmes *Ligjit për arsimin në komuna*<sup>6</sup>. Komunat kanë përgjegjësi ndërtimin e objekteve arsimore dhe aftësuese, mirëmbajtjen dhe riparimin e ndërtesave dhe pajisjeve të institucioneve arsimore si dhe sigurimin e një ambienti të shëndetshëm.

MASHTI themelon edhe trupa tjera këshilluese dhe menaxhuese. Këshilli Shtetëror për Arsimim Parauniversitar (KSHAP) monitoron progresin në procesin e reformave në arsimin parauniversitar nga këndvështrimi kombëtar dhe ndërkombëtar, bën propozime për ndryshime, harton raporte këshillëdhënëse ose rekomandime për fusha të caktuara dhe diskuton çështje të tjera që i referohen nga ministri/ja.

5 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.04/L-032 për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës. Shtator 2011. Burimi: <https://bit.ly/3a6Enlm>

6 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.03/L-68 për arsimin në komuna. Qershor 2008. Burimi: <https://bit.ly/3v3xZum>

Ministria, përmes Agjencisë së Kosovës për Kurrikulum, Standarde dhe Vlerësim (AKKSV), harton Kornizën e Kurrikulumit të Kosovës (KKK). AKKSV është agjenci që udhëheq çështjet që kanë të bëjnë me zhvillimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e kurrikulumit, standardeve dhe vlerësimit. Inspektimi i institucioneve arsimore dhe aftësuese është përgjegjësi e Departamentit të Inspektionit pranë Ministrisë.

Arsimimi parauniversitar dhe parashkollor organizohet përmes një kornize të mësimit tërë jetësor sipas niveleve të Standardeve Ndërkombëtare të Klasifikimit të Arsimit (ISCED):

<b>Niveli 0</b>	<b>Arsimi parashkollor</b> (mosha zero deri në gjashtë vjeç);
<b>Niveli 1</b>	<b>Arsimi fillor</b> që zgjat pesë vite (prej moshës gjashtë vjeçare);
<b>Niveli 2</b>	<b>Arsimi i mesëm i ulët</b> që zgjat katër katër vite (prej moshës 12 vjeçare);
<b>Niveli 3</b>	<b>Arsimi i mesëm i lartë</b> që zgjat tri vite (prej moshës 15 vjeçare); dhe
<b>Niveli 4</b>	<b>Arsimimi postsekondar</b> në institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional në periudhën një deri dy vite (zakonisht nga mosha 18 vjeçare).

Shkollat fillore dhe të mesme të ulëta themelohen në çdo komunë. Komuna mund të themelojë dhe mbajë paralele të ndara në zonat në të cilat nuk ka shkollë amë. Komunitat, brenda territorit të tyre, sigurojnë ofrimin e shkollimit në nivelin 1, 2 dhe 3 të ISCED-it, në të gjitha gjuhët e mësimdhënies edhe nën numrin minimal për regjistrim të nxënësve të përcaktuar me akt nënligjor, ose ofrojnë alternativa, duke përfshirë në mes të tjerash, transportin e subvencionuar deri në vendin ku ofrohet shkollimi.

Objektet arsimore publike mund të ndërtohen nga komuna dhe të financohen nga buxheti i komunës dhe donacionet tjera. Kompetencat komunale në ndërtimin e objekteve arsimore përfshijnë identifikimin e nevojave për ndërtimin e objekteve arsimore, përcaktimin e lokacionit të objekteve dhe ofrimin e tokës komunale, përgatitjen e planit të zbatimit, projektimin e objektit, dhënien e lejes së ndërtimit, prokurimin e shërbimeve dhe materialeve të ndërtimit, inspektimet e nevojshme, dhënien e lejeve përfundimtare për vënie në përdorim të objektit dhe krijimin e kushteve normale për procesin e arsimimit dhe trajnimit. Komuna duhet të paraqesë konfirmimin për disponueshmërinë e tokës komunale për ndërtim, planin e implementimit të projektit dhe projektin përfundimtar të shkollës. Shkollat kanë buxhetin e tyre të ndarë nga komuna.<sup>7</sup>

<sup>7</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.03/L-068 për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.03/L-089 dhe Lijin nr.04/L-115. Burimi: <https://bit.ly/2KMz7Bo>

## Kriteret për themelimin dhe pushimin e veprimtarisë së institucioneve edukativo-arsimore

Bazuar në Ligjin për arsimin parauniversitar, MASHTI nxjerr akt nënligjor **për caktimin e kriterëve për themelimin e institucioneve të arsimit parauniversitar dhe shuarjen e veprimtarisë së tyre**. Sipas Udhëzimit administrativ të MASHTI nr.104/2020<sup>8</sup>, komuna, me pëlqimin e MASHTI, themelon institucione parashkollore dhe paralele të ndara të institucioneve edukative-arsimore brenda territorit të saj. Institucioni edukativo-arsimor dhe paralelja e ndarë mund të themelohen nëse plotësohen, ndër të tjera, edhe kriteret për raportin mësimdhënës-nxënës dhe ekziston arsyeshmëria ekonomike për themelimin e institucionit ose paraleles së ndarë.

Kurse, në kriteret e veçanta hyjnë edhe:

- Të paktën dy grupe edukative dhe të paktën 40 fëmijë për institucionet edukativo arsimore të nivelit 0;
- Të paktën një paralele për klasat 1-5, të paktën një paralele për klasën parafillore dhe minimumi 60 nxënës për institucionin edukativ-arsimor të nivelit 1;
- Të paktën dy paralele për klasat 6-9 dhe minimumi 160 nxënës për për institucionin edukativ-arsimor të nivelit 2;
- Të paktën nga një paralele për klasat 1-9, të paktën një paralele për klasën parafillore dhe minimumi 100 nxënës për për institucionin edukativ-arsimor të nivelit 1 dhe 2;
- Të paktën tri paralele për klasat 10-12 dhe minimumi 180 nxënës për institucionin edukativ-arsimor të nivelit 3;

Paralelet e ndara mund të themelohen nëse, përveç kushteve të përgjithshme, plotësohen edhe kushtet e veçanta si:

- Largësia nga institucioni amë nuk është më e vogël se katër kilometra;
- I ka të paktën dy paralele të nivelit 1 dhe 2 sipas ISCED-it;
- I ka të paktën 20 nxënës.

Pushimi i veprimtarisë së institucionit edukativ-arsimor ose paraleles së ndarë mund të inicohet nga MASHTI ose komuna në këto raste:

- Nëse institucioni ose paralelja e ndarë nuk i plotëson kushtet e veçanta të cilat janë marr për bazë kur është themeluar institucioni;
- Nëse nuk ekziston arsyeshmëria për vazhdimin e veprimtarisë;
- Nëse me vazhdimin e veprimtarisë rrezikohet shëndeti dhe siguria e nxënësve;
- Me rekomandim të Inspektoratit.

Me rastin e pushimit të veprimtarisë së institucionit, duhet të ekzistojë një plan konkret për transferimin e nxënësve në një institucion tjetër, për procedurat e transferimit dhepërcaktimin e mundësive për punësim të personelit të institucionit që pushon se vepruari.

8 Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Udhëzimi Administrativ (MASHTI) nr.104/2020 për kriteret dhe procedurat e themelimit dhe pushimit të veprimtarisë së institucioneve të arsimit parauniversitar. Shtator 2020.  
Burimi: <https://bit.ly/2MnAiHB>

## Kriteret për raportin mësimdhënës-nxënës

Në vitin 2013, me akt nënligjor, MASHTI ka vendosur kriteret për numrin maksimal të nxënësve për klasë dhe raportin mësimdhënës-nxënës.<sup>9</sup> Sipas Udhëzimit administrativ, në institucionet edukativo-arsimore raporti nxënës-mësimdhënës dhe nxënës për klasë/paralele duhet të jetë sipas tabelës në vijim.

**Tabela 1. Kriteret sipas Udhëzimit Administrativ 22/2013 për raportin mësimdhënës-nxënës**

Niveli	Raporti
Për fëmijët nën një vjet	2 edukatore për 8 fëmijë 2:8, maksimumi 10 fëmijë
Për moshën 1-2 vjet	2:12, maksimalja e lejuar është 12 fëmijë
Për moshën 2-3 vjet	2:14, maksimalja e lejuar është 16 fëmijë
Për moshën 3-4 vjet	2:20, maksimalja e lejuar është 22 fëmijë
Për moshën 4-5 vjet	2:22, maksimalja e lejuar është 24 fëmijë
Për moshën 5-6 vjet	2:24, maksimalja e lejuar është 26 fëmijë
Numri i nxënësve në një klasë/paralele për nivelin e parë (1-5)	30, maksimumi i lejuar është 35 nxënës
Numri i nxënësve për klasë/paralele Për nivelin e dytë (6-9) dhe tretë (10-12) për gjimnaze	32, maksimumi i lejuar 35 nxënës
Raporti mësimdhënës-nxënës në nivelin e parë (1-5) për nënësit e komunitetit shumicë është	1:21.3
Raporti mësimdhënës-nxënës për nivelin e dytë (6-9)	1:21.3 për komunitetin shumicë; 1:14.2 për komunitetin pakicë;
Raporti mësimdhënës-nxënës për nivelin e tretë (10-12) për gjimnazet	1:21.3 për komunitetin shumicë; 1:14.2 për komunitetin pakicë;
Raporti mësimdhënës-nxënës për shkollat në zona malore (700+ metra lartësi mbidetare)	1:14.3 për komunitetin shumicë; 1:14.2 për komunitetin pakicë
Rapoti mësimdhënës-nxënës në nivelin e tretë (10-12) për arsimin profesiona	1:17.2 për komunitetin shumicë; 1:11.5 për komunitetin pakicë
Numri i nxënësve për klasë/paralele për shkollat e mesme profesionale për mësimin teorik	32 nxënës, ndërsa maksimumi një paralele mund ti ketë 35 nxënës
Numri i nxënësve për klasë/paralele për shkollat e mesme profesionale për mësimin praktik	16 nxënës, ndërsa maksimumi një paralele mund ti ketë 19 nxënës
Numri i nxënësve për klasë/paralele për shkollat për shkollat profesionale artistike	15 nxënës

Burimi: GAP, bazuar në Udhëzimin administrativ nr.22/2013


9 Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Udhëzimi Administrativ nr.22/2013 numri maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës-nxënës. Burimi: <https://bit.ly/3iL4zKN>

## Statistika të përgjithshme rreth arsimit parauniversitar

MASHTI publikon të dhëna të përvitshme dhe të detajuara për arsimin parauniversitar, si numri i nxënësve në të gjitha nivelet, shkollat dhe paralelet e ndara, numri i mësimdhënësve, personelit administrativ dhe ndihmës, raportet mësimdhënës-nxënës, etj.

Të dhënat e MASHTI tregojnë për një rënie të vazhdueshme të numrit të nxënësve në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Nga viti shkollor 2008/2009 deri në vitin shkollor 2019/2020 numri i nxënësve ka rënë për 26%, apo për 114,323 nxënës.

**Grafikoni 1. Numri total i nxënësve në arsimin parauniversitar**




Burimi: GAP, bazuar në statistikat e arsimit të MASHTI

Përveç Komunës së Fushë Kosovës, Komunës së Zveçanit dhe asaj të Novobërdës<sup>10</sup> të cilat kanë rritje të numrit të nxënësve, dhe Komunës së Leposaviçit e cila ka numrin e njejtë, në të gjitha komunat tjera është shënuar rënie e numrit të nxënësve. Rënie më e madhe është shënuar në komunat Kamenicë (-44%), Junik (-42%), Viti (-39%), Dragash (-39%); të gjitha këto komuna kufitare dhe me territor malor.

<sup>10</sup> Rritja e numrit të nxënësve në Komunën e Novobërdës është shënuar pas decentralizimit, ku një pjesë e Komunës së Gjilanit dhe Komunës së Kamenicës i kanë kaluar Komunës së Novobërdës. Nga viti shkollor 2013/2014 edhe në Komunën e Novobërdës ka rënie të vazhdueshme të numrit të nxënësve.




**Grafikoni 2. Trendi i numrit të nxënësve sipas komunave**



Burimi: GAP, bazuar në statistikat e arsimit të MASHTI

Përderisa ka rënie të numrit të nxënësve, të dhënat tregojnë se personeli arsimor (mësimdhënës, personel administrativ dhe ndihmës) është rritur për 2% për të njëjtën periudhë krahasuese.


### Grafikoni 3. Trendi i numrit të mësimdhënësve



Burimi: GAP, bazuar në statistikat e arsimit të MASHTI

Rritja ka ndodhur tek personeli ndihmës, përderisa ka rënie të numrit të mësimdhënësve dhe personelit administrativ.

### Grafikoni 4. Trendi i numrit të personelit arsimor<sup>11</sup>




Burimi: GAP, bazuar në statistikat e arsimit të MASHTI

<sup>11</sup> Nga viti shkollor 2013/2014 MASHTI ka filluar publikimin e të dhënave të ndara edhe për personelin administrativ dhe ndihmës.

Nëse e shikojmë në bazë të komunave, nga viti shkollor 2013/2014, vit prej kur MASHTI publikon të dhëna për tërë pesonelin arsimor (mësimdhënës, personel ndihmës dhe administrativ) deri në vitin shkollor 2019/2020, numri i personelit është rritur në disa komuna kurse ka rënë në disa të tjera. Për shembull, në Komunën e Vitisë, në të cilën numri i nxënësve ka rënë për 39% nga viti 2008/2009, personeli është rritur për 10%; në Komunën e Junikut është rritur për 22%. Në anën tjetër, në Komunën e Fushë Kosovës ka rënie të personelit arsimor për 1%, përderisa rritje të nxënësve për 17%.

### Grafikoni 5. Trendi i numrit të mësimdhënësve



Burimi: GAP, bazuar në statistikat e arsimit të MASHTI


Përgjatë viteve edhe raporti mësimdhënës-nxënës ka rënë. Në arsimin e mesëm të lartë, raporti mësimdhënës-nxënës ka rënë për pesë nxënës në periudhën 2012/2013 deri 2019/2020; në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët ka rënë për 2.6 nxënës dhe në arsimin parafillor për 3.8 nxënës.

**Tabela 2. Raporti mësimdhënës-nxënës**

Niveli i arsimit	Viti shkollor							
	2012/13	2013/14	2014/15	2015/16	2016/17	2017/18	2018/19	2019/20
Çerdhe	-	1/10	1/9.7	1/9.7	1/8.9	1/9.9	1/9.5	1/9.4
Arsimi parafillor	-	-	1/23.6	1/22.4	1/22.2	1/21.7	1/20.5	1/19.8
Arsimi fillor/mesëm i ulët	1/16.6	1/16.9	1/16.4	1/15.5	1/15.1	1/14.6	1/14.3	1/14
Arsimi i mesëm i lartë	1/19.2	1/18.3	1/15.6	1/15.9	1/16.4	1/16.4	1/15.4	1/14.2

Burimi: GAP, bazuar në statistikat e arsimit të MASHTI


Në nivelin parashkollor (çerdhe), raporti edukatorë-nxënës dallon shumë prej komunës në komunë. Përderisa në Komunën e Klinës, raporti është 1:21.8, në Komunën e Pejës raporti është 1:2.54. Shumë komuna ende nuk kanë institucione publike parashkollore.

**Grafikoni 6. Raporti edukatorë-fëmijë në nivelin parashkollor sipas komunave**

Burimi: GAP, bazuar në statistikat e arsimit të MASHTI

Në nivelin parashkollor, fillor dhe të mesëm të ulët, raporti mësimdhënës-nxënës po ashtu dallon shumë nga komuna në komunë. Raportin më të lartë e mban Komuna e Fushë Kosovës (1:23.68), gjersa raportin më të ulët ndër komunat e banuara nga komuniteti shumicë e mban Kamenica (1:8.16).


**Grafikoni 7. Raporti mësimdhënës-nxënës në nivelin parafilior, fillor dhe të mesëm të ulët sipas komunave**



Burimi: GAP, bazuar në statistikat e arsimit të MAShtI


Ndërsa, në nivelin e mesëm të lartë, dallimi mes komunave është më i vogël se sa në nivelet tjera. Edhe në nivelin e mesëm të lartë, raporti është më i larti në Komunën e Fushë Kosovës, kurse më i ulëti në komunat Dragash dhe Novobërdë.

**Grafikoni 8. Raporti mësimdhënës-nxënës në nivelin e mesëm të lartë**



Në të gjitha komunat funksionojnë 1,094 institucione edukativo-arsimore parauniversitare.


**Grafikoni 9. Numri i shkollave në vitin shkollor 2019/2020**



Burimi: GAP, bazuar në statistikat e arsimit të MASHTI

Gjatë pesë viteve të fundit (2015-2020), MASHTI ka investuar mbi 134.5 milionë euro në infrastrukturën shkollore.

**Grafikoni 10. Investimet e MASHTI në infrastrukturën shkollore (në €)**



Burimi:  
Instituti GAP, bazuar në  
buxhetet vjetore të Kosovës  
nga viti 2015 deri 2020

## Gjendja e shkollave në komuna

Gjatë muajve nëntor dhe dhjetor 2020, Instituti GAP ka kërkuar qasje në të dhënat e detajuara për numrin e nxënësve në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar nga të gjitha komunat. Njëzet e dy komuna kanë dërguar të dhëna, por të dhënat janë të paplota ngase nuk përmbajnë të dhëna të detajuara në bazë të shkollave dhe klasëve, por të dhëna të përgjithshme.

Por, në bazë të të dhënave të siguruara, del se në 19 komuna (shih aneksin 1) janë 340 klasa që kanë pesë e më pak nxënës<sup>12</sup> dhe 642 klasa që kanë më pak se dhjetë nxënës.

**Tabela 3. Numri i klasave (1-9) sipas numrit të nxënësve**

Numri i nxënësve	Numri i klasëve
1-5 nxënës	340
6-10 nxënës	642
11-20 nxënës	1343
21-30 nxënës	791

Në këto 19 komuna, janë 26 shkolla që kanë më pak se 60 nxënës, 127 shkolla që kanë 61 deri 160 nxënës, si dhe 292 shkolla me mbi 161 nxënës.

Në aneks janë paraqitur të gjitha shkollat, numri i nxënësve, klasët dhe mesatarja e nxënësve për klasë në 19 komuna që kanë dërguar të dhëna më të plota në bazë të kërkesës së Institutit GAP për qasje në dokumente publike.

Në vijim kemi paraqitur gjendjen në shkollat e disa komunave, për të cilat kemi aritur të sigurojmë të dhëna të detajuara në nivel lokaliteti, shkolle dhe klase. Këto komuna përballen me rënien më të madhe të numrit të nxënësve.

### Komuna e Kamenicës

Duke parë rënien e numrit të nxënësve, uljen e raportit mësimdhënës-nxënës, si dhe rritjen e shpenzimeve, Komuna e Kamenicës, në vitin 2019, ka ndërmarrë një iniciativë për riorganizimin e shkollave fillore dhe të mesme në territorin e saj. Ulja e numrit të nxënësve në Komunën e Kamenicës është më e larta në Kosovë, ku prej vitit shkollor 2008/2009 numri i nxënësve gati është përgjysmuar (-44%).

Sipas një raporti të detajuar nga kjo komunë, përderisa numri i nxënësve ka rënë, numri i personelit ka mbetur thuajse i pa ndryshuar. Po sipas raportit, 40% e shkollave nuk kanë mjedis të përshtatshëm higjienik, tetë shkolla nuk kanë as toaleta, gjysma e shkollave nuk kanë kabinete të informatikës, 24 nga 29 shkolla janë pa salla sportive të mbyllura dhe 10 shkolla nuk kanë hapësira për rekreacion.<sup>13</sup> Në anën tjetër, në vitin 2019, Komuna e Kamenicës kishte vetëm 30,000 euro buxhet për investime kapitale<sup>14</sup> në 29 shkolla. Udhëzimi administrativ i MASHTI për planifikimin e investimeve kapitale vendos kritere për ndërtimin, renovimin, inventarizimin e objekteve edukativo-arsimore, ku sipas Komunës së Kamenicës

<sup>12</sup> Në kalkulim janë përfshirë edhe paralelet e ndara dhe shkollat që zhvillojnë mësim në gjuhën e komuniteteve pakicë.

<sup>13</sup> Komuna e Kamenicës. Raport mbi organizimin e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta në Komunën e Kamenicës. Gusht 2019. Raport i siguar nga Instituti GAP në nëntor 2020 në bazë të kërkesës për qasje në dokumente zyrtare.

<sup>14</sup> MASHTI. Udhëzimi Administrativ nr.04/2018 për planifikimin e investimeve kapitale. Shkurt 2018. Burimi: <https://bit.ly/3qYir99>



nuk mund të bëhen investime në ato objekte shkollore amë ku ka më pak se 210 nxënës si dhe në paralelet e ndara ku numri i nxënësve është më i vogël se 84. Në Komunën e Kamenicës, 51% e shkollave kanë më pak se 70 nxënës: gjashtë shkolla kanë më pak se pesë nxënës, gjashtë shkolla më pak se 20 nxënës, dhe tri shkolla kanë më pak se 70 nxënës.

Përveç kësaj, numri i vogël i nxënësve për klasë, sipas Komunës së Kamenicës, pamundëson zbatimin e Kornizës Kurrikulare të Kosovës, ngase kjo kornizë kërkon që të kalohet nga ligjërimi në punë grupore. E në klasët ku ka më pak se 15 nxënës është vështirë që të organizohet mësimi grupor me nxënës. Arsye tjetër që është përmendur është edhe mungesa e socializimit, ngase numri i vogël i nxënësve pamundëson socializimin dhe të mësuarit nga ndërveprimi me bashkëmoshatarët.

Me qëllim të zvogëlimit të kostos, rritjen e mirëqenies së nxënësve, rritjen e profesionalizmit dhe sigurimin e hapësirave adekuate për nxënie, nga viti shkollor 2019/2020, Komuna e Kamenicës vendosi të mbajë mësimin në tetë shkolla, duke organizuar transportin për nxënësit. Edhe pas riorganizimit, gjysmës së nxënësve nuk do t'i nevojitej që të udhëtonin; 23% e nxënësve do të udhëtonin në distancë më të vogël se pesë kilometra, ndërsa 20% e nxënësve në distancë më pak se 10 kilometra.

Objektet e mbetura zbrazët pas riorganizimit të shkollave, Komuna e Kamenicës parasheh që të përdoren për qëllime tjera, qoftë si institucione parashkollore ose të përdoren për nevojat e komunitetit. Sfidën më të madhe që ka paraparë Komuna e Kamenicës ka të bëjë me mësimdhënësit tepricë, të cilën parasheh ta zgjidhë duke i risistemuar në vende tjera ose duke arritur marrëveshje kolektive konform Ligjit të punës.

Mirëpo, kjo strategji e komunës hasi në rezistencën e komunitetit, prindërve, partive politike dhe nuk gëzoi mbështetjen e nivelit qendror. Një pjesë e madhe e prindërve ndaluan fëmijët që të udhëtojnë, duke bërë që të humbet një pjesë e vitit shkollor. Prindërit organizuan protesta para komunës si dhe para MASHTI<sup>15</sup>.

Duke parë këtë rezistencë, MASHTI i kërkoi Komunës së Kamenicës që të shtyjë ekzekutimin e vendimit për një pjesë të shkollave, por të mos braktiset reforma e filluar. MASHTI, po ashtu njoftoi se do të bëjë një studim të gjerë për të parë gjendjen e shkollave edhe në komunat tjera.<sup>16</sup>

## **Komuna e Drenasit**

Komuna e Drenasit, në shtator të vitit 2018 ka mbyllur tri shkolla në tri fshatra të kësaj komune (në fshatin Abri, Gjergjica dhe në fshatin Godanc). Rreth 200 nxënës të këtyre fshatrave janë transferuar në shkollat fillore të qytetit, duke ua siguruar transportin.<sup>17</sup>

Në arsyetimin për mbylljen e këtyre shkollave përmenden tri arsye kryesore: 1. Numri i vogël i nxënësve. 2. Numri i madh i mësimdhënësve në këto tri shkolla. 3. Shpenzime të shumta buxhetore për mirëmbajtjen e këyre shkollave.<sup>18</sup>

15 Top Channel. Banorët e Kamenicës protestojnë para MASHTI-it, kërkojnë të mos mbyllën shkollat. 21 tetor 2019. Burimi: <https://bit.ly/32twPfq>

16 Hykmete Bajrami – Ministre e Arsimit dhe Shkencës, 26 shkurt 2020. Postim në llogarinë e saj private në Facebook. Burimi: <https://bit.ly/2MfiDSC>

17 RTV 21. Komuna e Drenasit mbyll tri shkolla - 29.10.2018. Burim: <https://bit.ly/3cSOpPV>

18 Intervistë me Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Drenasit Muhamet Gjoka. 06.04.2021.

Nga vlerësimi që ka nxjerr DKA në Drenas, del që Komuna e Drenasit ka kursyer 30,312 euro në vit nga mbyllja e këtyre tri shkollave, ndërsa ka ndikuar pozitivisht edhe në cilësinë e mësimin të nxënësve të transferuar nga këto fshatra për në shkollat e tjera, veçmas në pikëpamje të socializimit dhe ndjenjen e konkurrueshmërisë në mësimnxënie.<sup>19</sup>

### **Komuna e Deçanit**

Komuna e Deçanit bën pjesë në komunat me rënien më të madhe të popullsisë dhe numrit të nxënësve. Në shkollat në zonat rurale të kësaj komune janë 33 klasë ku numri i nxënësve është nga 1 deri 9; kurse 111 klasë nga 10 deri 19 nxënës.

